



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 2222 60

Nr. 32 Prot.

Tiranë, 26.10.2009

UDHËZIM

Nr. 32, datë 26.10.2009

PËR
REGJISTRIMIN E DHE VLERËSIMIN E NXËNËSVE QË KANË PËRFITUAR AZIL NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9098, datë 03.07.2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë"

UDHËZOJ:

1. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, regjistrohen në arsimin parashkollor mbi bazën e certifikatës së lindjes. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojnë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.
2. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, por nuk zotërojnë certifikatën e lindjes të regjistrohen në arsimin parashkollor sipas dëshmisë së prindërve dhe dokumentacionit që ai zotëron në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojnë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.
3. Nxënësi që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, për të vazhduar studimet në arsimin bazë ose të mesëm të regjistrohet në bazë të dokumentit shkollor të shtetit nga vjen, të përkthyer e noterizuar dhe të sigluar në DAR/ZA sipas vendbanimit ku ai është vendosur. Nxënësi regjistrohet në:
 - a) klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;
 - b) klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor
4. Nxënësi i shkollës 9-vjeçare, që nuk provon me dokument shkollor të shtetit nga vjen vazhdimin apo përfundimin e një klase, provohet për shkallën e njohurive nga një Komision i Posaçëm që ngrihet në DAR/ZA. Komisioni harton proces-verbalin përkatës të firmosur nga të gjithë anëtarët e tij. Mbi bazën e këtij proces-verbali që depozitohet në DAR/ZA, drejtori i DAR/ZA lëshon vërtetimin për regjistrimin e nxënësit në klasën që miraton ky komision. Shkolla në të cilën regjistrohet nxënësi, mban në amzën e vet vërtetimin e mësipërm.

7. Nxënësi i cili ka kryer 8 vite shkollore, regjistrohet në klasën e 9-të me ose pa shkëputje nga puna sipas moshës që ka.
6. Për regjistrimin e tij nxënësi paraqet pranë DAR/ZA dëftesë (dëftesat) origjinale të përkthyer dhe noterizuara. DAR/ZA bën konvertimin dhe ekuivalentimin e notave dhe siglon dëftesën e nxënësit. Drejtori i DAR/ZA përcakton shkollën ku do të vazhdojë studimet nxënësi që plotëson kushtet e mësipërme.
7. I huaji azilant i cili provon me dokumente përfundimin e shkollës së mesme ka të drejtë të konkurojë për tu regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik (IAL), sipas udhëzimeve përkatëse që harton MASH, për kriteret e ekuivalentimit dhe regjistrimit në IAL.
8. Shtetasit që NUK zotërojnë dokumentet e përfundimit të arsimit të mesëm , NUK mund të përfitojnë nga e drejta e arsimimit në IAL.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare dhe Drejtorja e Kurrikulës dhe Monitorim Vlerësimit,.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR



MYQEREM TAJ